

19.12.2022

Ora 12:33

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtim paraprak të kërkesës ankimore nr. 10, datë 9.12.2022, objekti “Kundërshtim i vendimit nr.224, dt.7.12.2022” të Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve, subjekti ankues PDK”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, z. Erdal Mema, znj. Blerta Ereqi.
- **Parti Politike:** PDK, PR, PSD, BD, PBKD, Nisma Thurje
- **Të Tjerë:** TV-Mat, A2 CNN

Z. K. Bele: Atëherë sipas axhendës së sotme do ta fillojmë me shqyrtimin e kërkesës Ankimore regjistruar me nr. 10, me kërkues Partia Demokristiane e Shqipërisë, me objekt “Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 224, dt.7.12.2022. Nga shorti i hedhur sipas procedurës, relator i këtij shqyrtimi administrativ pranë KAS-it, jam unë Koli Bele. Prezent është gjithë trupa e KAS-it. Konstatojmë prezencën e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së si dhe pjestarë të tjerë. Besoj duhet të kemi përfaqësues të ankuesit? Prezantohuni!

Znj. Ariona Hoxha, përfaqësuese e PDK: Jam Ariona Hoxha, përfaqësuese e PDK.

Z. K. Bele: Po, faleminderit! Në këtë moment, sipas procedurës që rregullohet nga Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore në zbatim, jemi në fazën e verifikimit të elementëve të formës dhe përmbajtjes para kalimit të kërkesës në seancën e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*


shqyrtimit në themel të saj. Besoj jeni në dijeni për procedurën. Paraprakisht i japim fjalën përfaqësuesit të KQZ-së të na shpjegojë shkurtimisht me dy fjalë se përse jemi mbledhur dhe pastaj vijojmë me pyetjet dhe shqyrtimin.

Z. Y. Merkaç: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka shqyrtuar në seancë administrative raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për kuvend të datës 25 prill 2021. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur miratimin e gjetjeve të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe ka vendosur t'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masave administrative gjorbë për partitë politike, ndër të cilat dhe Partia Demokristiane e Shqipërisë. Kundër këtij vendimi të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendimi nr.224, dt.7.12.2022, ka bërë ankesë subjekti ankues Partia Demokristiane e Shqipërisë, me kërkesën ankimore nr.10, dt.9.12.2022. Në mungesë dhe autorizim të anëtarëve të KAS-it, referuar nenit 14 të Rregullores së KAS-it është hedhur shorti për relatorin dhe është caktuar relator zoti Koli Bele. Nga shqyrtimi i kërkesës ankimore shohim se elementët e formës dhe përmbajtjes janë në përputhje me nenin 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor, faleminderit!

Z. K. Bele: Përfaqësuesi i ankuesit? Duhet të keni parasysh se jemi në fazën e parë të verifikimit vetëm të formës dhe përmbajtjes. Kemi ndonjë gjë për të shtuar?

Znj. Ariona Hoxha, përfaqësuese e PDK: Në raportin e auditit, për Partinë Demokristiane të Shqipërisë thuhet se “shpenzimet e aktivitetit të fushatës dieta dhe ushqim, nuk kanë dokumenta tatimore. Mungesa e të cilave mund të gjenerojë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

minimalisht detyrime tatimore duke filluar nga baza 15% e shumës së shpenzimeve, në masën nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind lekë”. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duke ju referuar këtij vendimi...

Z. K. Bele: Më fal, pa ju ndërprerë se do të kesh të drejtën tënde të flasësh, po nuk jemi duke verifikuar faktet, jemi vetëm tek forma dhe objekti i ankimit. Përfaqësuesi i KQZ-së tha që sipas tij, objekti i plotëson kushtet e kriteret. Besoj ju jeni dakord me këtë gjë?

Znj. Ariona Hoxha, përfaqësuese e PDK: Po, po, dakord!

Z. K. Bele: Dakord atëherë, në një fazë tjetër do të vazhdoni. Kolegët, kanë ndonjë gjë?

Z. I. Rusmali: Ju ankoheni ndaj vendimit të Komisionerit, apo jo? Çfarë pasojash sjell ky vendim për ju?

Znj. Ariona Hoxha, përfaqësuese e PDK: Arësyeja financiare! Gjoha që është vënë...

Z. I. Rusmali: Vendimi çfarë sjell për ju, çfarë interesash të ligjshme ju prek? Duhet të jetë pak konkrete përgjigjia.

Znj. Ariona Hoxha, përfaqësuese e PDK: Unë jam vetë ekonomistia e partisë dhe masa administrative është kundrejt meje.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

Z. I. Rusmali: Dakord!

Z. K. Bele: Për ekonomi administrative rreth procesit, ne po i dëgjojmë të gjitha ankimet, meqenëse kanë dhe objekt të ngjashëm dhe pastaj tërhiqemi për vendim dhe të shprehemi lidhur me këtë fazë të procesit që të mos e bëjmë hyrje-dalje dhe ne kemi kuadrin më të plotë. Besoj kjo është dhe më e pranueshme edhe për ju si procedurë. Tërhiqemi për vendim për këtë fazë dhe do të shprehemi njëherazi për të gjitha, ndërkohë vazhdojmë me të tjerat. Me kaq mbyllet shqyrtimi në këtë fazë për kërkesën ankimore nr. 10. Vazhdon kolegu me kërkesën tjetër!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

19.12.2022
Ora 12:40

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtim paraprak të kërkesës ankimore nr. 11, datë 12.12.2022, objekti “Kundërshtim i vendimit nr.224, dt.7.12.2022” të Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve, subjekti ankues PR”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, z. Erdal Mema, znj. Blerta Ereqi.
- **Parti Politike:** PDK, PR, PSD, BD, PBKD, Nisma Thurje
- **Të Tjerë:** TV-Mat, A2 CNN

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve, çelim seancën për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore me nr. 11, me subjekt ankimues Partia Republikane e Shqipërisë, me objekt “Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 224, dt.7.12.2022”. Kjo seancë do të kryesohet nga unë Elvis Çefa sipas përcaktimeve të shortit hedhur në datën 12.12.2022. Fillimisht verifikojmë prezencën. Prezent është gjithë trupa e KAS-it. Është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe stafi i tij administrativ. Pala ankimuese, ju lutem prezantohuni nga Partia Republikane?

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR-së: Përfaqësues i Partisë Republikane, Arjan Madhi.

Z. K. Bele: Përfaqësuesi ka ndonjë kërkesë paraprake lidhur me ndonjë arsye për përjashtimin e ndonjërit nga anëtarët e KAS-it për shqyrtimi e kësaj çështjeje?

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR-së: Ne nuk kemi asnjë ankesë.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

Z. E. Çefa: Po, faleminderit! Nga kolegët e KAS-it ndonjë kërkesë paraprake për konflikt interesi? Nuk ka! Kështu që mund të vazhdojmë. Sikurse e thamë zoti Madhi, sot jemi vetëm në vlerësimin paraprak të kërkesës. Themeli do të jetë objekt i një diskutimi të një seance tjetër. Ftoj shkurtimisht Sekretarin e Përgjithshëm të parashtojë rrethanat e fakteve.

Z. Y. Merkaç: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 224, dt.7.12.2022 ka vendosur miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për kuvend të datës 25 prill 2021. Në pikën 8 të këtij vendimi i është propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për marrjen e masave administrative për partitë politike, Partia Republikane. Ky subjekt zgjedhor ka bërë ankesë me kërkesën ankimore nr.11, dt.12.12.2022. Referuar nenit 14 të Rregullores së KAS-it është hedhur shorti për relatorin dhe është përcaktuar si relator zoti Elvis Çefa. Nga një vështrim i shpejtë i kërkesës ankimore arrihet në konkluzionin se kërkesa ankimore plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes sipas nenit 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Ku është përcaktuar kompetenca e KQZ-së për të shqyrtuar ankimin, në rastin konkret KAS-i. Është legjitimuar ankuesi pasi çënohen të drejtat financiare të tij, si dhe është respektuar afati ligjor i paraqitjes së ankimit, faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit! Për palën ankuese, diçka për të thënë, në qoftë se keni?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR-së: Për sa kohë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shprehet dakord me kërkesën tonë, për sa i takon procedurës dhe përmbajtjes nuk kemi asgjë. Kur të fillojë shqyrtimi në themel do të shprehemi.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Sikurse e tha dhe kolegu në çështjen ankimore të mëparëshme, ne për ekonomi po vendosim të dëgjojmë të gjitha palët duke qenë se janë të ngjashme dhe pastaj ne në fund do të shpallim vendimet për të dy kërkesat ankimore që i përkasin subjekteve politike. Po e ndërpresim këtu këtë seancë, ne do të diskutojmë dhe do të shpallim pastaj vendimet për të dy kërkesat ankimore, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

19.12.2022
Ora 12:45

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtim paraprak të kërkesës ankimore nr. 12, datë 12.12.2022, kërkesa ankimore nr.14 dt.13.12.2022, objekti “Kundërshtim i vendimit nr.224, dt.7.12.2022” të Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve, subjekti ankues Mat Tv dhe OSHMA A2 CNN”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, z. Erdal Mema, znj. Blerta Ereqi.
- **Parti Politike:** PDK, PR, PSD, BD, PBKD, Nisma Thurje
- **Të Tjerë:** TV-Mat, Tv A2 CNN

Z. L. Braho: Përshëndetje, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë drejtuar dy kërkesa ankimore për të cilat jam relator unë. Është kërkesa nr. 12, me ankues Mat Tv dhe kërkesa nr. 14 e shoqërisë G-2 Media, që është respektivisht Tv A2 CNN, që po ashtu kanë kundërshtuar vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 224, dt.7.12.2022. Çelet seanca për shqyrtimin e kërkesave paraprake për kriteret formale në lidhje me këto ankime. I japim fjalën përfaqësuesit të KQZ-së për një relativitet të shkurtër.

Z. Y. Merkaj: Siç e relatova dhe më parë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 224, dt.7.12.2022 ka miratuar raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për kuvend të datës 25 prill 2021. Ku ndër të tjera ka propozuar dhe ka vendosur masë për vendosjen e gjobës së Tv Mat në Burrel. Kundër këtij vendimi subjekti që është

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022**

gjobitur ka bërë ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve Referuar nenit 126 të Kodit Zgjedhor, konkretisht pikave “b”, “d” dhe “e”, ankimi nuk i plotëson elementët e formës pasi nuk i është referuar vendimit që ankimohet. Nuk është përshkruar tregimi i provave për të cilat është marrë gjatë procesit të shqyrtimit si dhe nuk ka bërë një përshkrim të fakteve dhe argumentave dhe dispozitave ligjore të cilat mbështetet ankimi. Në lidhje me kërkesën ankimore nr. 14 kundër vendimit nr.224 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ka bërë ankim Shoqëria 2 G Media CNN dhe një vështrim i shpejtë i ankimit konstatohet se është në përputhje me nenin 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor, faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Merkaj! Ka përfaqësues të Tv Mat këtu në sallë?


Z. Mustafa Gjini, përfaqësues i Tv Mat: Po, Mustafa Gjini! Jam përfaqësues i Tv Mat

Z. L. Braho: Faleminderit! Ju çfarë qëndrimi keni në lidhje me atë që sapo relatoi përfaqësuesi i KQZ-së? Mund të flasësh me mikrofon, të afroresh diku këtu!

Z. Mustafa Gjini, përfaqësues i Tv Mat: Atëherë, e dëgjova përshkrimin, absolutisht nuk mund të bie dakord me sa u tha për faktin se shkurtimisht, Tv Mat nuk ka pasur asnjë kontratë dhe...

Z. L. Braho: Dëgjo, që të flasim dhe të jemi të qartë. Kjo seancë është vetëm për shqyrtimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes. Një nga pretendimet që ngriti përfaqësuesi i KQZ-së është që ju nuk keni cituar vendimin që ankimoni. Mund të ma thoni kë vendim të KQZ-së ankimoni?

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

Z. Mustafa Gjini, përfaqësues i Tv Mat: Ne ankojmë vendimin nr.222, dt. 7.12.2022 orën që është shpallur për të gjitha televizionet e tjera lokale dhe subjektet. Bëhet fjalë ...

Z. L. Braho: 222, apo 224?

Z. Mustafa Gjini, përfaqësues i Tv Mat:224, sa është ai!

Z. L. Braho: Po pra, se këtë kërkojmë ne të sqarohet?

Z. Mustafa Gjini, përfaqësues i Tv Mat:Vendimin nr. 224, masa administrative që është propozuar për tridhjetë mijë lekë gjobë, si e pabazuar dhe pa fakte.

Z. L. Braho: Element tjetër zoti Merkaj që ju ngritët që nuk kishte plotësuar?\

Z. Y. Merkaj: Nuk ka përshkruar objektin e shkeljes dhe dokumentet provuese të shkeljes nuk i ka bashkëlidhur.

Z. L. Braho: Keni prova ju në lidhje me pretendimet që ngrini, përveç vendimit të Komisionerit?

Z. Mustafa Gjini, përfaqësues i Tv Mat: Po! Shkurtimisht me pak fjalë provat janë këto: Tv Mati nuk ka asnjë kontratë, asnjë reklamë nuk ka transmetuar për asnjë subjekt politik. As më parë dhe as deri tani. Nëse gjendet një dokument, një reklamë,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

qoftë e një subjekti politik që është transmetuar në Tv Mat, atëherë le të vazhdohet me masën siç e keni propozuar.

Z. L. Braho: Faleminderit! Për Tv A-2, ose Shoqërinë G 2 Media ka përfaqësues?

Z. Sidi Hodo, përfaqësues i A 2 CNN: Po!

Z. L. Braho: Mund të afroresh të lutem?

Z. Sidi Hodo, përfaqësues i A 2 CNN: Për sa kohë është pranuar kërkesa formale, atëherë nuk kemi ndonjë gjë!

Z. L. Braho: Identifikohuni si fillim?

Z. Sidi Hodo, përfaqësues i A 2 CNN: Po, ndjesë! Sidi Hodo nga A 2 CNN.

Z. L. Braho: Po, faleminderit, pra jeni dakord, mirë! Kisha unë një pyetje për administratën e KQZ-së në fakt. Mund të ma sqaroni përse është proceduar me një vendimmarrje për të dyja këto? Pra, edhe për partitë politike dhe për televizionet, ku një vendimmarrje është me propozim, një vendimmarrje tjetër është me sanksion?

Z. Y. Merkaj: Duke qenë se objekti i shqyrtimit ka qenë raporti i gjetjeve për fondet e përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, duke qenë se ka qenë raport i gjetjeve të cilat i implikon të dyja dhe partitë politike edhe televizionet që transmetojnë reklamat nga partitë politike, kemi menduar t'i bëjmë në një mbledhje.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

Z. L. Braho: Dakord! Ka pyetje kolegu!

Z. E. Çefa: Kam një pyetje për administratën e KQZ-së. Të dhënat që ju keni konkluduar në gjobitjen e mediave, televizioneve. Monitorimin e ka bërë AMA, apo jo? Kështu rezulton nga vendimmarrja. Pra matjen e minutazhit nga reklamat?

Z. Y. Merkaç: Po për OSHMA-të e ka bërë AMA.

Z. E. Çefa: Unë do të kisha propozuar, nuk e di nëse janë kolegët e tjerë, por ne do të na duhet një opinion, ose një e dhënë më specifike për mënyrën dhe parametrat se si AMA i mat dhe klasifikimin që bën ndërmjet kohës reklamës dhe kohës tjetër televizive. Unë do të kisha propozuar në qoftë se dhe kolegët janë dakord t'i bëjmë një ftesë për seancën tjetër eventuale të themelit edhe një përfaqësuesi të AMA-s që ne ta pyesim në detaj. Unë të paktën do të dua ta pyes pak më tepër për këtë.

Z. Y. Merkaç: Me sa jemi ne në dijëni, ka një metodologji që është miratuar nga AMA dhe që i kontrollon dhe verifikon të gjitha OSHMA-të. Megjithatë është në të drejtën tuaj ta ftojme.

Z. L. Braho: Ka pyetje të tjera?

Z. K. Bele: Më fal, nuk e kuptova drejt, për Tv Mat!? Pavarësisht se ne do të diskutojmë, thotë “unë nuk kam bërë asnjë reklamë”. Ndërkohë për shkak dhe të volumit të raportit dhe duke qenë se s’kam qenë relator i kësaj çështjeje, ku e gjejnë në material pretendimin ose atë çfarë AMA pretendon për reklamat dhe minutazhin

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

e këtij televizioni për këtë qëllim? Apo lidhet vetëm me faktin e mosraportimit. Pra për të kuptuar pak a shumë themelin? Pra, ky televizion është sot në këtë shqyrtim se nuk ka raportuar, apo se rezulton që të ketë transmetuar “x” minutazh për qëllime politike?

Z. Y. Merkaj: Unë di që vendimi i Komisionerit është bazuar tek informacioni i ardhur nga AMA, por konkretisht nuk mund ta them për momentin.

Z. K. Bele: Dakord, kemi nevojë për kohë.

Z. L. Braho: Në fakt dhe mua te ky raporti i bashkëlidhur nuk më rezulton që partitë politike të kenë deklaruar për shpenzime te Tv Mat. Se me çfarë po kuptoj nga raporti, çdo parti politike ka bërë deklarime se te cila media ka shpenzuar në lidhje me aktivitetin e fushatës dhe Tv Mat nuk më rezulton tek asnjë nga deklaratimet e partive. Mbase ky është moment për t’u sqaruar nga ana e administratës së KQZ-së.


Z. Y. Merkaj: Në faqen 35, 36 të raportit, thuhet që “OSHMA-të private që nuk kanë dorëzuar tarifat e tyre zyrtare” dhe ky është konstatimi i AMA-s. Tarifat zyrtare i paraqesin në KQZ.

Z. I. Rusmali: Pra kjo do të thotë që konstatimi është i KQZ-së nuk ka lidhje me raportin.

Z. Y. Merkaj: Po! Ndër televizionet që nuk ka dorëzuar tarifat është dhe Tv Mat.

Z. L. Braho: Tarifat kur depozitohen, para fushatës?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

Z. Y. Merkaj: Po! Neni 84, pika 5 i Kodit Zgjedhor.

Z. L. Braho: Dakord! Atëherë edhe në lidhje me këto dy kërkesa ankimore do të shprehem me vendimmarrje pasi të dëgjojmë dhe kërkesat e mbetura.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

19.12.2022
Ora 12:54

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin paraprak të kërkesës nr. 13, datë 12.12.2022
objekti “Kundërshtim i vendimit nr.224, dt.7.12.2022” të Komisionerit Shtetëror i
Zgjedhjeve”, subjekti ankues Club Tv”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Z. Erdal Mema, Znj. Blerta Ereqi.
- **Parti Politike:** PDK, PR, PSD, BD, PBKD, Nisma Thurje
- **Të Tjerë:** TV-Mat, Tv A2 CNN

Z. I. Rusmali: Unë jam caktuar relator për trajtimin e kërkesës ankimore me nr. 13, dt.12.12 2022, paraqitur nga Club Tv Chanel. Sipas procedurës, është ndonjë përfaqësues i këtij subjekti këtu? Nuk ka përfaqësues ankuesi! Pavarësisht nga kjo, ne kemi detyrimin ta shqyrtojmë ankesën dhe të marrim vendim lidhur me të. Anëtarët e komisionit kanë ndonjë gjë paraprake në lidhje me ndonjë konflikt interesi të mundshëm? Nuk kanë! Deri tani këtë kërkesë ankimore e ka administruar administrata e KQZ-së, cili është vlerësimi juaj paraprak për kërkesën?

Z. Y. Merkaj: Në KQZ ankimi ka ardhur në rrugë elektronike me e-mail dhe është drejtuar te Drejtoria Juridike. Mendojmë se nuk i përmbush elementët e formës dhe përmbajtjes të nenit 126 të Kodit Zgjedhor, pasi nuk është në formën e kërkuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Nuk ka vendosur bazën ligjore ku e bazon ankimin dhe nuk ka treguar provat të cilat kërkohen të merren gjatë procesit të shqyrtimit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

Z. I. Rusmali: Lidhur me afatin e paraqitjes së kërkesës?

Z. Y. Merkaj: Brenda afatit të parashikuar!

Z. I. Rusmali: Është brenda afatit! Kanë pyetje kolegët? Unë kam një pyetje për sqarim procedurial më shumë. Pse për këto subjekte tregtare për radio televizionet, Komisioneri ka vendosur drejtë për drejtë sanksione me vendimin e tij, ndërkohë që për partitë politike i ka propozuar KAS-it vendosjen e sanksioneve? Kush është arësytimi ligjor mbi këtë diferencim?


Z. Y. Merkaj: Dispozita ligjore ku mbështetet vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve tregon se për partitë politike duhet t'i bëhet propozim KAS-it për marrjen e masës administrative, ndërsa për OSHMA-të është vetë Komisioneri kompetent për vendosjen e masës administrative.

Z. I. Rusmali: Referencat ligjore të lutem na ndihmoni se kemi nevojë për këtë.

Z. Y. Merkaj: Neni 84, pika 5, neni 71, pika 1 e Kodit Zgjedhor.

Z. I. Rusmali: Dakord! Ndonjë pyetje tjetër nga kolegët? Nuk ka! Mirë, edhe për këtë kërkesë ne do të shprehemi në fund bashkë me të tjerat.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

19.12.2022
Ora 12:58

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin paraprak të kërkesës nr. 04, datë 14.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vendosje sanksioni administrativ”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, z. Erdal Mema, znj. Blerta Ereqi.
- **Parti Politike:** PDK, PR, PSD, BD, PBKD, Nisma Thurje
- **Të Tjerë:** TV-Mat, Tv A2 CNN

Z. I. Rusmali: Tani jemi te çështja e fundit e rendit të ditës. Kërkesa Ankimore me nr.4, dt.14.12.2022. Prezent është administrata, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Subjektet politike që janë prezente këtu, a deklarohen palë të interesuara në shqyrtimin e kësaj kërkesë, automatikisht, apo duhet të shprehen? Apo jeni vetëm dëgjues me këtë rast? Dakord, mund ta sqarojmë edhe më vonë. Ka ndonjë deklaram nga kolegët? Nuk ka deklarime!

Z. R. Preçi, përfaqësues i PSD: Jam Rustem Preçi, përfaqësues i PSD. Jemi shumë dakord me listat e KQZ-së, ndaj partisë sonë..

Z. I. Rusmali: Ju doni të deklaroheni palë e interesuar në shqyrtimin e kësaj kërkesë, këtë po thua?

Z. R. Preçi, përfaqësues i PSD: Jo, unë kam për të thënë diçka meqenëse mbaruat.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

Z. I. Rusmali: Jo ne nuk kemi mbaruar akoma.

Z. Y. Merkaj: Në fakt pranë administratës ka ardhur një kërkesë nga Partia Balli Kombëtar e cila është titulluar “parashtrime” lidhur me objektin që po shqyrtojmë, por nuk ka...

Z. I. Rusmali: Lidhur me këtë çështje që po shqyrtojmë? Nga Balli Kombëtar?

Z. Y. Merkaj: Po! Nga Balli Kombëtar Demokrat!

Z. I. Rusmali: Pra, nga Balli Kombëtar Demokrat që është prezent këtu?

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. I. Rusmali: Dakord dhe shpreheni të interesuar për të marrë pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje.


Përfaqësues i PBKD: Po, po!

Z. I. Rusmali: Keni ndonjë kërkesë paraprake për KAS-in? Ndonjë rezervë ndaj anëtarëve të KAS-it?

Përfaqësues i PBKD: Jo, jo nuk kemi!

Z. I. Rusmali: Nuk keni! Mirë, le të na e prezantojë pak administrata, Sekretari i Përgjithshëm, shkurtimisht përmbajtjen e kërkesës.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Në përfundim të procesit administrativ Komisioneri vendosi miratimin e gjetjeve të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje. Në bazë të nenit 34 të Rregullores së KAS-it ku sanksionohet e drejta për të vënë në lëvizje Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve i ka propozuar KAS-it marrjen e masave administrative për partitë politike si më poshtë:

Partia Demokratike;

Partia Demokristiane;

Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar;

Partia Lëvizja e Legalitetit;

Partia Socialiste;

Kandidati i Partisë Politike “Lëvizja e Re”, zoti Fitim Tahelala;

Partia Republikane;

Partia Balli Kombëtar Demokrat;

Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë;

Partia Nisma Thurje;

Partia Bindja Demokratike;

Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare;

Partia Socialdemokrate;

Partia Balli Kombëtar;

Në përfundim, referuar nenit 34 e 35 të Rregullores së KAS-it, i është drejtuar KAS-it për marrjen e masave administrative, duke përcaktuar dhe gjordat përkatëse me vlerat përkatëse, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Ju si palë e interesuar, keni ndonjë gjë për të diskutuar lidhur me legjitimitimin e Komisionerit? Lidhur me kompetencën e tij? Lidhur me kompetencën e KAS-it për ta shqyrtuar këtë kërkesë? Ky është debati sot në këtë seancë!

Përfaqësues i PBKD: Sigurisht, nuk është se jam i fushës dhe jurist, por me aq sa perceptoj unë është që.. ne kërkojmë një vendim tuajin i cili duhet të rrëzojë në një farë mënyre propozimin e Komisionerit...

Z. I. Rusmali: Pra, po thoni që jeni dakord që ne të shqyrtojmë kërkesën e Komisionerit, me sa kuptojmë? Po nuk e shqyrtuam nuk marrim dot vendim!

Përfaqësues i PBKD: Po sigurisht që do ta shqyrtoni!

Z. I. Rusmali: Mirë, faleminderit! Pyetje nga kolegët? Ka ndonjë gjë për të thënë? Mirë, edhe për këtë ne... kjo është e fundit në fakt, ne tani duhet të tërhiqemi për të marrë vendimin për secilën kërkesë ankimore dhe për kërkesën e paraqitur nga Komisioneri. Mund ta lemë paraprakisht që të rimblidhemi këtu në orën 13:40?

Z. K. Bele: Në 13:45.

Z. I. Rusmali: Dakord, në orën 13:45 do të mbledhemi këtu, ku ne të deklarojmë vendimet.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

RIFILLON SEANCA

Ora 13:46

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, z. Erdal Mema, znj. Blerta Ereqi.
- **Parti Politike:** PDK, PR, PSD, BD, PBKD, Nisma Thurje
- **Të Tjerë:** TV-Mat, Tv A2 CNN

Z. K. Bele: Riçelim shqyrtimin e kërkesave ankimore duke filluar nga ajo me nr. 10. KAS pasi shqyrtoi në këtë fazë, konstaton dhe vendos që kjo kërkesë të kalojë për shqyrtim themeli. Në të njëjtën mënyrë, KAS ka të njëjtin konstatim edhe për Kërkesën Ankimore me nr. 11, si dhe për kërkesën e Komisionerit për vendosje sanksioni administrativ, e cila është kërkesa me nr. 4. Sipas rregullimit ligjor dhe praktikës, këto kërkesa do të bashkohen në një kërkesë të vetme dhe do të shqyrtohen në një seancë, duke qenë se kanë të njëjtin objekt. KAS konstaton se procedura për propozimin për sanksion do të duhej të ishte kërkesë për vendosje sanksioni, pa pasur nevojë për një vendim të Komisionerit. Gjithësesi kjo është një gjë që do të trajtohet dhe do të jetë pjesë e shqyrtimit në themel. Duke qenë se këto çështje nuk lidhen me këto zgjedhje dhe afatet e ngushta që sjellin zgjedhjet që zhvillojmë, por kanë të bëjnë me zgjedhjet e kaluara, duke i dhënë mundësinë dhe palëve pjesëmarrëse që kanë interes të ligjshëm, sidomos subjektet elektorale të cilat janë gjobitur, por dhe palëve të tjera të interesuara në qoftë se ka të tilla, seanca që caktohet për shqyrtim do të jetë në dt.16 janar 2023, në orën 12:30. Të treja këto kërkesa ankimore dhe çdo pjesëmarrje e palëve të tjera që kanë interes të ligjshëm, do të shqyrtohen në një


**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

proces të vetëm me të njejtin objekt. Me kaq e deklaroj të mbyllur shqyrtimin për këtë pjesë për këto tre kërkesa.

Vendimi nr. 24

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

RIFILLON SEANCA

Ora 13:48


PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, z. Erdal Mema, znj. Blerta Ereqi.
- **Parti Politike:** PDK, PR, PSD, BD, PBKD, Nisma Thurje
- **Të Tjerë:** TV-Mat, Tv A2 CNN

Z. L. Braho: Atëherë, në lidhje me kërkesat ankimore nr. 12, nr. 13 dhe nr. 14 që janë respektivisht nga subjektet Mat Tv, Club Tv dhe A2 CNN, KAS vendosi kalimin e këtyre kërkesave për shqyrtim. Gjithashtu dhe bashkimin e kërkesave ankimore në zbatim të nenit 132 të Kodit Zgjedhor. Në lidhje me datën e seancës, duke qenë se sipas KAS afati i ankimit në lidhje me këtë vendimmarrje duhet të jetë afati 30-ditor meqenëse nuk jemi në periudhë zgjedhore në lidhje me këto shkelje, do të lihet kohë dhe seanca do të zhvillohet në datën 17.01.2023, ora 12:30. Po ashtu i kërkojmë administratës së KQZ-së që të njoftojë dhe AMA-n për të sjellë përfaqësues në lidhje me këtë çështje për pyetje që mund të lindin gjatë shqyrtimit administrativ. Seanca deklarohet e mbyllur.

Z. K. Bele: Për të treja këto kërkesa që bashkohen, duke qenë se ka një diskutim se cila është kërkesa e parë, po ne ecëm me parimin që e para e hedhur në short do të trajtohet si kërkesa e parë që në bashkim i thith dhe kërkesat e tjera. Relator për të tre çështjet do të jem unë Koli Bele.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.12.2022*

Z. L. Braho: Ndërsa për çështjet e mediave që kanë të bëjnë me sanksionet administrative të vendosura ndaj mediave, relator do të jetë anëtari Ledio Braho.

Vendimi nr. 25

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

